

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANI

URDHËR

Nr. 13 datë 24 /08/2022

Për procedurat e aplikimit, konkurimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për kandidatët që aplikojnë në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet për vitin akademik 2022-2023

Mbështetur në nenin 42 (Drejtuesi i Njësisë kryesore), neni 74 (pranimi në ciklin e parë të studimeve) të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", **Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 436, datë 03.06.2020, Për "përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve , në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim"**; **Urdhërin e përbashkët nr. 8, datë 30/06/2022, të QSHA dhe QNRRASH "Për miratimin e kalendarit për procesin e aplikimit dhe të regjistrimit, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022-2023"**; **Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar ; Udhëzimin nr.16, datë 29/06/2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 10, datë 15/05/2019, "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; Vendimeve të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve si më poshtë: VSA Nr. 09, datë 02/02.2022; VSA Nr. 10, datë 02/02/2022: VSA Nr. 11, datë 02/02/2022; VSA Nr. 17, datë 10/03/2022; VSA Nr. 18, datë 10/03/2022: VSA Nr. 19, datë 10/03/2022 : Urdhërin e Rektorit të UART nr. 40, datë 17/07/2022 Mbi "Marrjen e masave organizative për zbatimin e urdhërit të përbashkët nr.8 datë 30/06/2022 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022-2023", në Universitetin e Arteve", Statutin e Universitetit të Arteve,**

Urdhëroj

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në një nga programet e studimit të ciklit të parë bachelor në Fakultetin e Artit Skenik, aplikojnë pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik nga data 02/09/2022 deri 13/09/2022.
2. Aplikimi për transferim studimesh mund të bëhet nga një program studimi njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, i ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose IAL-



- të jopublike të lincesuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja.
3. Në datë 17/09/2022 Sekretaria Mësimore shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar. Kjo listë bëhet publike.
 4. Aplikimet për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisionet e ngritura për këtë qëllim me urdhër të dekanit të fakultetit brenda datës 23/09/2021.
 5. Kandidati që ka aplikuar për program të dytë në një program studimi të ciklit të parë bachelor, do të nënshtrohet kritereve të pranimit të përcaktuara në rregulloren e konkursit.
 6. Shqyrtimi i kërkesave të kandidatëve do të bëhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur duke kryer vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi si dhe udhëzimeve të MASR dhe Rregulloren e konkursit e Rregulloren mësimore të ciklit të parë Bachelor.
 7. Konkursi i pranimit për këtë kategori kandidatësh do të zhvillohet në datën **23/09/2022**
 8. Aplikimi kryhet nga kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës të MASR. Sekretaria Mësimore të zbatojë me korrektesë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.
 9. Kandidatët e kategorive të mësipërme, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e përcaktuar në udhëzimin e MASR për këtë qëllim.
 10. Lista me renditjen e kandidatëve bërë nga komisionet afishohet nga sekretaria mësimore në datë 24/09/2022. Në listën e publikuar fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të miratuara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.
 11. Në datë 27/09/2022 shpallet lista përfundimtare me renditjen e kandidatëve fitues në faqen elektronike të UART si dhe në mjediset e FAS.
 12. Kandidatët regjistrohen në një nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datave 07/10/2022 deri 11/10/2022.
 13. Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Artit Skenik, brenda datës 15/12/2022 dërgon pranë QSHA-së në formë shkresore dhe elektronike në format Excel listën e studentëve të regjistruar.
 14. Ky urdhër t'ju bëhet me dije për zbatim Shefave të Departamenteve. Një kopje e këtij urdhëri dërgohet në Rektorat.
 15. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri: Zv/dekani i FAS, Përgjegjësit e Departamenteve në FAS, Kryetarja e Degës së FAS, Sekretaria Mësimore e FAS, Komisionet e pranimit në FAS, Personeli administrativ i përcaktuar me detyra specifike për mbarëvajtjen e konkursit.
 16. Ky urdhër shpallet në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik. Një kopje e urdhërit dërgohet pranë Rektoratit të UART

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Petrit MALAJ

DEKAN